



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 125 Prot.

Tiranë, më datë 08.02.2021

VENDIM
Nr. 40 , datë 08.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale” dhe Urdhrit Nr.223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.02.2021:

VENDOSI:

1. Shtyrje vendimmarrje për projektin “Rikonstruksion i objektit ekzistues 1 kat + shtesë anësore”, në Zonën Arkeologjike B, Durrës, me zhvillues familja Çyrbja dhe raport vëzhgimi arkeologjik realizuar nga personi i licencuar në arkeologji Ylli Cerova:
 - Subjekti zhvillues duhet të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të përgatisë një koncept sondazhi në kuadër të projektit;
2. Koncepti i sondazhit duhet të vijë për shqyrtim në KKTKM;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

